



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.218/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bradiqi Kryesues Kujtim Pasuli, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Nova Demokrtaska Stranka (NDS), me seli në Prizren paraqitur kundër Nasha Boshnjaqka Koalicia me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.01.2025, merr këtë :

V E N D I M

- I. Pranohej si e bazuar ankesa e Subjekti Politik Nova Demokrtaska Stranka (NDS), me seli në Prizren, me shenjë Anr.218/2025 e datës 27.01.2025,
- II. Nasha Boshnjaqka Koalicia (NBK), me seli në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjobë në shumë prej 1,500.00 (Njëmijë e pesëqind) euro, për shkak të manipulimit të votave të votuesve jashtë Kovove, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.
- III. Koalicionit Boshnjak Nasha (NBK), me seli në Prizren detyrohet ta paguaj gjobën në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 27.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.218/2025, nga subjekti politik Nova Demokrtaska Stranka (NDS), paraqitur kundër Nasha Boshnjaqka Koalicia (NBK), në cilën pretendon se kandidati Zarif Lajtifi i cili është në listën zgjedhore me numër rendor 121, dhe si kandidat me numër 28, ka bere shkelje të procesit zgjedhor nëpërmjet ndikimit të votuesit dhe manipulimit të mundshëm të votave të votuesve në diasporë, i njëjti ka postuar në profilin e tij, në rrjetin social zyrtar Facebook, një njoftim me foto të fletëvotimeve të mbushura dhe zarfeve të destinuar për dërgim nga diaspora në Kosovë.

Me tutje ankuesi pretendon se njoftimi, që i bashkëngjitet kësaj ankese si provë, shihet qartë se kandidati ka plotësuar personalisht disa fletëvotime dhe i ka përgatitur për dërgim me postë. Ky lloj veprimi tregon për manipulim të mundshëm të votave, pra votimi në emër të personave të tjerë, që është shkelje e parimit të fshehtësisë së votës dhe vullnetit të lirë të votuesit. Andaj konsideroj se ky veprim rezulton në shkeljen e procesit zgjedhor të parashikuar nga Ligji për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, konkretisht:

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Si provë ka bashkangjitur, pamjet e ekranit (screenshots) te postimit ne Facebook që tregojnë fletëvotet të plotësuar dhe zarfet gati për te dërguar dhe linkun e postuar: <https://www.facebook.com/share/p/1BUPRUR45s/>, po ashtu fotografi që dëshmon thirrjen e kandidatit qe fton publikisht votuesit si dhe informacion te disponueshëm publikisht ne lidhje me procedurën e votimit përmes postes.

Në përgjigje në ankesë të Koalicionit Boshnjak NBK, pretendojnë se supozimet nuk janë të bazuara, dhe se nuk ekziston shkelje e qartë e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme të Republikës së Kosovës. Andaj me analizën e ankesës dhe dëshmive më poshtë në mënyrë të detajuar e kemi arsyetuar pse besojmë se kandidati Zarif Ljatifi nuk ka shkelur ligjin. Fshehtësia e votimit nuk është shkelur, Fotografitë e fletëvotimit me shenjën simbolike të numrit të kandidatit nuk është materiali real që u përdor në zgjedhje, dhe këto fletëvotime janë padyshim pjesë e aktiviteteve të marketingut, e cila është edhe praktikë e zakonshme në kampanjat politike. Asnjë nga provat nuk tregon se janë fletëvotimet reale dhe se janë plotësuar ose manipuluar nga anët e kandidatit Zarif Latifi , e as që më këtë janë shkelur parimet fshehtësisë së votimit. Po ashtu ne përgjigjen në ankesë pretendohet se asnjë provë nuk përcakton pretendimet e ankesës që z. Zarif Latifi ka ndikuar në votues, dhe se ne emër të askujt personal nuk ka plotësuar fletëvotimin, nuk është rrezikuar pavarësia e vendimmarrjes së votuesit. Kandidati Zarif Latifi në njoftimet të tiji therët votuesit për të shfrytëzuar të drejtën e votës, e cila është legjitime dhe inkurajon pjesëmarrje demokratike në proces votimi. Asnjë provë nuk tregon se kandidati Ljatifi personalisht ka plotësuar ose dërguar fletëvotimet në emër të personave tjerë. Ligji për të Zgjidhjet e Përgjithshme iu mundëson kandidatëve të drejtë në lirinë shprehjes dhe udhëheqje të fushatës. Kjo liri përfshin dhe përdorimin e materialeve promovuese, rrjeteve sociale dhe forma tjera komunikimi në mënyrë që të motivohen votuesit për të votuar . Asnjë dëshmi nuk tregon se kandidati Latifi ka bërë shkelje të këtij procesi, vetëm thjesht ka informuar votuesit për të drejtën e tyre .

Andaj bazuar në analizën e dëshmive të bashkangjitura ne përgjigjen ne ankesë, konstatojmë se kandidati Zarif Latifi nuk ka shkelur asnjë dispozitë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dëshmitë e Bashkangjitur nuk vërtetojnë asnjë shkelje të fshehtësisë së votës ,dhe ndikim në votuesit, dhe sa keqpërdorimin e procesit zgjedhorë. Kandidati Latifi ka vepruar në përputhje ligj dhe ka shfrytëzuar metodat e lejuara me ligj për promovimin kandidaturës së tij .Ne sugjerojmë që ankesa të refuzohet si e pa bazuar sepse ajo në të vërtetën është e tillë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se

Ankesa është e bazuar.

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se kandidati Zarif Lajtifi, nga Nasha Boshnjaqka Koalicija (NBK), ka bërë shkelje ligjore duke publikuar fotografitë me fletëvotime në rrjetet sociale, e cila fotografimin përmban numrin, mënyrën dhe subjektin politik te votimit, veprim ky që është në kundërshtim dhe me nenin 52 paragrafi 1 e cila përcakton se: *“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës, gjatë periudhës që fillon me hapjen e vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të tyre.”*

Pretendimet në përgjigje në ankesë të Nasha Boshnjaqka Koalicija (NBK), ku thuhet se asnjë provë nuk përcakton pretendimet e ankesës që kandidati Zarif Latifi ka ndikuar në votues, dhe se në emër personal të askujt nuk ka plotësuar fletëvotimin, dhe se nuk është rrezikuar pavarësia e vendimmarrjes së votuesit me publikimin i fletëvotimeve në rrjetet sociale të tij, Paneli konsideron se është përgjegjësi penale e kandidatit në fjalë që kanë bërë këtë shkelje dhe i takon prokurorisë së shtetit të merret me çështjen në fjalë, këtë pretendim paneli e ka marrë parasysh por zhvillimi i procedurës penale, nuk është arsye që ankesa të mos shqyrtohet pasi PZAP është i kufizuar vetëm nëse ekziston shkelja e pretenduar, ndërsaq në këtë rast kemi të bëjmë me nenin 33.5 të LZP-së përcakton se: Subjektet politike mbahen përgjegjës për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik që konsiston në faktin së Nasha Boshnjaqka Koalicija (NBK), ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit, që dalin nga shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi. *Andaj, PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Nasha Boshnjaqka Koalicija (NBK) është përgjegjëse për veprimet e saja pasi sipas vendimit dt.08.01.2025 me nr.01/25 të KQZ për miratimin e dizajnimin e fletëvotimit të broshurës që për votuesit jashtë Kosovës, votimi fillon në ora 09.01.2025 deri 08.02.2025.*

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 33 paragrafi 1 neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 218/2025 më datën 30.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së